



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 4627

Prishtinë, Dt. 01/11/2024

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Matematikë / Master në Shkencë Kompjuterike
Projekt propozimi	Zbatimi i algoritmeve të të mësuarit të makinës për parashikimin e prodhimit të energjisë nga panelet solar
Kandidati	Lyra Dobruna
Mentori	Prof. Ass. Dr. Artan Berisha
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 28.03.2024 Vendimi nr.: 1105

Vlerësimi i dorëshkrimit

Hyrje

Punimi i diplomës me titull "Zbatimi i algoritmeve të të mësuarit të makinës për parashikimin e prodhimit të energjisë nga panelet solar" ka për qëllim të përdorë llojet e ndryshme të algoritmeve të të mësuarit të makinës, në të dhëna reale të fermave solare në Kosovë. Duke zbatuar ato algoritme, punimi tenton të gjejë atë që sjell rezultat më të mirë.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i dorëshkrimit është bërë në saje të punës origjinale, cilësisë hulumtuese, metodologjisë, analizës dhe prezantimit në dorëshkrim.

Përmbajtja e detajuar

Në kapitullin e parë, kandidatja diskuton llojet e të mësuarit të makinës dhe faktorët e ndryshëm që ndikojnë në prodhimin e energjisë solare.

Kapitulli i dytë përmbledh një rishikim të literaturës bazë, duke u fokusuar në hulumtimet e

ngjashme që kanë përdorur algoritme të të mësuarit të makinës në parashikim të energjisë solare. Kapitulli i tretë fillon me prezantimin e të dhënave të përdorura, për të vazhduar me gjuhën programuese të përdorur dhe duke dhënë një analizë statistikore të mbi të dhënat.

Kapitulli i katërt paraqet në detaje algoritmet e përdorur, si dhe masat e vlerësimit të saktësisë së tyre por edhe optimizimin e hiperparametrave, me anë të metodave të ndryshme.

Kapitulli i pestë, bën përmbledhjen e eksperimenteve dhe pastaj diskutimin e tyre. Aty diskutohen rastet veç e veç, duke krahasuar rezultatet në mes veti.

Kapitulli i gjashtë përmbledh temën nga këndvështrimi i kandidatës.

Përmbledhje e të gjeturave


Punimi i diplomës Master ka një analizë të mirë të algoritmeve, teknikave dhe të dhënave të përdorura. Për më shumë ka një kapitull ku bën një krahasim të punëve të ngjashme. Kandidates i është kërkuar që të ndryshojë dhe modifikojë temën nga komisioni paraprakisht në mënyrë që tema të paraqitet në formën më të mirë. Nga këndvështrimi i komisionit, kandidatja i ka inkorporuar në punim diplomës vërejtjet dhe sugjerime.

Konkludim


Në përgjithësi tema e diplomës Master i përmbush standardet për të fituar gradën shkencore Master. Komisioni rekomandon pranimin e temës, pas ndryshimeve të vogla, të cilat kandidatja i ka rregulluar, duke i përcjellë komentet e anëtarëve.

Prishtinë, 31/10/2024


Komisioni:

1. 
/ Prof. Ass. Dr. Eliot Bytyçi

– kryetar/

2. 
/ Prof. Ass. Dr. Artan Berisha

– anëtar/

3. 
/ Prof. Ass. Dr. Korab Rrmoku

– anëtar/